



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

BURSA PËR STUDIME UNIVERSITARE DHE

PASUNIVERSITARE NË GREQI, VITI AKADEMIK 2018-2019

Në kuadër të bashkëpunimit arsimor me Greqinë, Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Greqisë shpall Programin e Bursave për studime universitare, pasuniversitare, kërkimore, kurse vere për studentët e huaj, të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë në Greqi për vitin akademik 2018-2019. Kandidatët e interesuar për bursat e studimit, të cilët nuk e njohin gjuhën greke, do t'i nënshtrohen vitit përgatitor të kësaj gjuhe për një vit akademik, i cili fillon në shtator të vitit 2018.

Gjithashtu, pala greke në kuadër të shkëmbimeve akademike ofron vizita studimore për lektorë shqiptarë, të cilët dëshirojnë të kryejnë vizita pune pranë institucioneve të arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor në Greqi.

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe përgatitjes së dokumentacionit, ju lutemi referojuni adresës në web: <https://www.minedu.gov.gr>. Bashkëlidhur këtij njoftimi ndodhen formularët e aplikimit.

Për sa më sipër, kandidatët brenda datës **4 qershor 2018** që është edhe afati fundit për aplikim duhet të dorëzojnë dokumentacionin përkatës në adresën e mëposhtme:

*37 Andreas Papandreou Street ,
Postcode city: 151 80 Maroussi, Greece
Website: <https://www.minedu.gov.gr>
Tel: 210 344 2404
Fax: 210 344 2365*

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS